

VENDIM
Nr.330, datë 22.4.2020

PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHETETËRORE “SISTEMI I DEKLARIMIT TË PASURISË DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT – EACIDS”

(ndryshuar me VKM nr. 37, datë 27.1.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) të bazës të të dhënave shtetërore “Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS”, i cili do të aksesohet në faqen zyrtare të internetit të Inspektoratit.

2. ILDKPKI-ja është përgjegjëse për krijimin, mbajtjen, administrimin e bazës të të dhënave “Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS”, dhe për ndërveprimin e përmbajtjes së tij me bazat e tjera të informacionit.

3. Të dhënat që përmban “Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS” ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti në deklaratat e interesave private.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat e marra nga ndërveprimi me baza të tjera të të dhënave të informacionit pranë institucioneve, si më poshtë vijon:

- i. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC);
- ii. Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);
- iii. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT);
- iv. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR);
- v. Njësia e Trajtimit të Koncesioneve/PPP (ATRAKO);
- vi. Agjencia e Prokurimit Publik (APP);
- vii. Sistemi Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (HRMIS);
- viii. Thesari;
- ix. Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS);
- x. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK);
- xi. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD);
- xii. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE);
- xiii. Bankat, institucionet financiare jobankare, përfshirë edhe fondet e investimeve dhe të pensioneve;

xiv. Çdo bazë tjetër të dhënash që mund të ndërveprojë me “Sistemin e Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS”.

3/1. Të dhënat, që përmban “Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS”, mbrohen nëpërmjet një niveli sigurie që siguron enkriptimin e të dhënave që ruhen në të.

4. Dhënës të informacionit për këtë bazë të dhënash janë, si më poshtë vijon:

a) Personat që janë subjekt i deklarimit, sipas ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar;

b) Institucionet:

i. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI);

ii. Bankat, institucionet financiare jobankare, përfshirë edhe fondet e investimeve dhe të pensioneve;

iii. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

iv. Institucione të tjera shtetërore, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

5. Niveli i aksesimit në sistemin elektronik dhe bazën e të dhënave të EACIDS është, si më poshtë vijon:

a) Individët që janë subjekt deklarimi dhe personat e lidhur me ta kanë akses në pjesën e sistemit, nga ku mund të kryejnë deklarin, si dhe të shtojnë e të lexojnë vetëm të dhënat që kanë lidhje me ta, si dhe të modifikojnë ose të fshijnë për sa kohë nuk kanë aprovuar versionin përfundimtar të deklaramit.

b) ILDKPKI-ja ka akses si administrator dhe përdorues në EACIDS. Niveli i aksesimit, funksionet dhe të drejtat për përdoruesit e sistemit janë në përputhje me pozicionin e punës dhe përcaktohen në rregulloren e “Sistemit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë/Interesave Private dhe Konfliktit të Interesave”, të miratuar nga ILDKPKI-ja, në zbatim të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

c) Çdo person i interesuar, duke mos u kufizuar, individë, person juridik, privatë ose publikë, masmedia-n, shoqërinë civile, i cili ka akses për të lexuar ose marrë informacionin e publikuar në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. *Personi i interesuar për aksesimin e sistemit elektronik dhe bazën e të dhënave EACIDS regjistrohet me llogari përdoruesi të posaçme dhe fjalëkalim, duke paraqitur saktë identitetin e tij me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit.*

6. Ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore dhe procedurat e realizimit të ndërveprimit përcaktohen në rregulloren e “Sistemit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë/Interesave Private dhe Konfliktit të Interesave”, të miratuar nga ILDKPKI-ja, në zbatim të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

7. Funksionet dhe të drejtat e secilit përdorues janë në përputhje me pozicionin e punës dhe të përcaktuara në rregulloren e “Sistemit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë/Interesave Private dhe Konfliktit të Interesave”, të miratuar nga ILDKPKI-ja, në zbatim të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

8. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën software dhe hardware të EACIDS-së, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe të praktikave evropiane e ndërkombëtare, bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave është administratori i vetëm dhe përgjegjës i drejtpërdrejtë për strukturën e bazës të të dhënave të “Sistemit të Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS”, në anën funksionale dhe operacionale.

10. Ngarkohet Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama